MATERIALE

Gjurmime albanologjike
Seria e shkencave historike
30-2000

Hysen KORDHA
Tiranë

VËSHTRIM MBI NJË DOKUMENT

Rreth programit të Partisë Kombëtare, themeluar nga Aqif Elbasani në Baden të Austrisë në prill 1923

Për Aqif Pashë Elbasanin, si personalitet historik dhe si figurë e shquar e historisë kombëtare të popullit shqiptar, është shkruar dhe është folur pak, ndonëse, për shkaqe tashmë të tejkaluara e të nënkuptuara, jo në masën që e meriton dhe i takon të flitet për të. Sot rrethanat e reja që garantojnë lirinë e mendimit e të kërkimit shkencor, lejojnë dhe favorizojnë procesin e rivlerësimit e të rishikimit të historisë, të ngjarjeve e të figurave, duke vënë në vend të vërtetën historike me objektivitet shkencor. Nisur nga synime e këndvështrime të tilla mendova të ndalem në analizën e një dokumenti pak të njohur: "Programit dhe rregullores të Partisë Kombëtare", të krijuar nga Aqif Pashë Elbasanin, në prill 1923, në Baden të Austrisë, ku ndodhej asokohe në mërgim.

Kohë më parë, gjatë hulumtimeve në fondet e Arkivit Qendror të Shtetit, më ra në dorë një informacion i konsullit shqiptar në Vjenë dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Tiranë mbi botimin dhe përmbajtjen e Programit të Partisë Kombëtare themeluar nga Aqif Pashë Elbasani në Baden të Austrisë.[1] Informacioni mban datën 4 maj 1923. Pas 9 ditësh më 14 maj konsulli i dërgoi Ministrisë së Jashtme në Shqipëri një "ekzemplar të Programit të Partisë Kombëtare".[2] Këto të dhëna më nxitën ta kërkoj e ta gjej një kopje të Programit dhe të Rregullores së Partisë Kombëtare. Ai ndodhet në fondet e Bibliotekës Kombëtare. Është një broshurë e vogël, me ballinë të kuqe me shirita të

[1] AQSH I RSH, fondi 251, viti 1923, dosja 69, fleta 24.
[2] AQSH I RSH, fondi 251, viti 1923, dosja 69, fleta 26; Shënim: Është botuar i plotë në revistën "*Studime Historike*" Nr. 1-4/1995, faqe 142-147.

zinj, pra me ngjyrat e flamurit kombëtar. Broshura ka 12 faqe, nga të cilat dy faqe janë thirrja e Aqif Pashës, 4 faqe kanë Programin e Partisë dhe 6 faqe përmbajnë rregulloren e saj.

Para se të ndalem me shqyrtimin e tyre në hollësi, mendoj të theksoj fare shkurt diçka mbi migrimin e Aqif Pashës nga Shqipëria në Austri. Për shkak të rrethanave politike (analiza e të cilave del jashtë objektivit të këtij artikulli), Aqif Pasha u detyrua të largohej nga Shqipëria e të mërgojë në Austri,[3] e cila asokohe ishte një nga metropolet e politikës, të diplomacisë e të kulturës evropiane, nga që mendimet e tij përparimtare e demokratike dhe qëndrimet liberale nuk përputheshin me qëndrimet e konceptet politike të qarqeve konservatore, të cilat zotëronin pushtetin shtetëror e politik. Ato iu kundërvunë frymës demokratike, liberale e orientimit perëndimor të vendimeve të Kongresit të Lushnjës, që drejtoi e kryesoi Aqif Pashë Elbasani, i cili punoi për plotësimin e tyre. Për këto arsye qarqet konservatore, në fshehtësi të plotë organizuan dëbimin e tij dhe të gjithë pasuesve të tij nga Shqipëria.[4] Ai u largua nga Shqipëria më 1 mars të vitit 1922[5] dhe u vendos në Baden të Austrisë, pastaj në Vjenë. Në Austri qëndroi deri në janar 1924, pas të cilit vit u kthye në Shqipëri.

Vendosja e tij në Austri nuk ishte rastësi. Ndonëse nuk pohohet në ndonjë burim, merret me mend dhe më shumë e besueshme që ai u vendos në rrethe njerëzish të njohur, të besuar e që garantonin jetën dhe veprimtarinë e tij. Qarqet politike austriake, përkrahës dhe simpatizantë të çështjes kombëtare shqiptare, prej kohësh kishin bashkëpunuar me Aqifin, për rrjedhojë i njihnin mirë qëndrimet e matura politike e atdhetare të tij në interes të shqiptarizmit e të kombit të vet. Ato e çmonin dhe e vlerësonin lart rolin, kontributet dhe gjithë veprimtarinë e tij në ecurinë e zhvillimeve politike të çështjes shqiptare. Prandaj, qarqet politike vjeneze u bënë përkrahëse të tij gjatë kohës në mërgim. Madje kontaktet e rregullta me ish konsujt austro-hungarezë, që kishin shërbyer në Shqipëri[6] në periudha të ndryshme, përbënin një nga punët më të rëndësishme dhe të vlefshme të Aqif Pashës në Austri. Këshillat dhe mendimet e tyre ai i vlerësonte me shumë kujdes dhe i merrte në analizë në kuadrin e interesave kombëtare. Koha e qëndrimit në emigracion

[3] Po aty, fondi 252, viti 1922, dosja 23, fleta 22.
[4] Po aty, dosja 23,fleta 23.
[5] Po aty, fleta 55.
[6] Po aty, fondi 251, viti 1923, dosja 69, fleta 86-87.

përbën një nga fazat më të vështira të jetës së tij, por njëherazi ajo i dha mundësinë të njihet më nga afër dhe t`i pasurojë bagazhin e bindjet e veta politike me koncepte të reja, me konceptet politike evropiane. Madje po të vërehet me kujdes, dallohet qartë evoluimi në sens pozitiv e progresiv, që pësuan konceptet dhe vizionet e tij për mjaft probleme të jetës politike, ekonomike, sociale, kulturore, juridike, ushtarake, të ndërtimit shtetëror, atyre për arsimin, legjislacionin etj. Mbi të gjitha shihet shumë qartë se konceptet politike të Aqif Pashës në mërgim morën trajta dhe një përmbajtje të re, shumë të avancuar, themelin e të cilave e përbënte synimi për krijimin e një shteti modern shqiptar, ku të dominonte demokracia, të garantoheshin liritë politike e të drejtat demokratike, të sigurohej drejtësia shoqërore dhe të vepronte shteti ligjor etj. Të gjitha këto ide e koncepte u formuluan në programin e Partisë Kombëtare, që e themeloi dhe e drejtoi Aqif Pashë Elbasani në Baden të Austrisë. Programi i Partisë Kombëtare u botua në prill 1923[7] në formë broshure në Baden. Broshura titullohej: "Programi dhe rregullorja e Partisë Kombëtare".

Para se të ndalemi në analizën e këtij programi, të përmbajtjes e të karakterit të tij, të synimeve, të qëllimeve politiko-sociale etj., dëshirojmë të japim ndonjë mendim për vetë Partinë Kombëtare, për atë formacion politik të ri shqiptar që u krijua në emigracion. Ideator, themelues, organizator dhe drejtues i saj ishte Aqif Pasha. Ende nuk dimë datën e saktë të themelimit. Përbërja e saj pak a shumë dihet, ishin kryesisht vetëm emigrantët politikë shqiptarë, që ndodheshin në Austri. Sa ishin? Vështirë të përgjigjemi, sepse me dokumentacionin që disponojmë, deri më sot nuk kemi të dhëna. Shpresojmë se mbase në të ardhmen do ta plotësojmë këtë boshllëk.

Themelimi i Partisë Kombëtare, ndonëse larg Shqipërisë, synonte t'i vinte në ndihmë jetës politike shqiptare, veçmas fuqizimit të forcave përparimtare dhe demokratike, sepse skenën e konkurrencës së alternativave politike shqiptare zhvillohej e plotësohej më tej spektri i forcave politike antikonservatore, ecej drejt konsolidimit e afirmimit të pluralizmit politik në Shqipëri, rritej shansi për fitoren e forcave liberal-demokratike. Me krijimin e partive politike në Shqipëri dhe jashtë saj (madje me sa dimë ne deri tani, Partia Kombëtare ishte e vetmja parti politike shqiptare e krijuar në emigracion gjatë viteve 1920-1924), skena politike shqiptare i largohej tradicionalizmit oriental dhe i afrohej më

[7] AQSH i RSH, fondi 251, viti 1923,dosja 69, fleta 24.

shumë mënyrës, strukturave organizative, koncepteve politike demokratike dhe përmbajtjes së zhvillimeve oksidentale, perëndimore, pra rrugës së zhvillimeve politiko-shoqërore të shteteve më të zhvilluara të Evropës Perëndimore, tendencë që nisi të përvijohet nga Kongresi Kombëtar i Lushnjës, të cilin siç dihet dhe, sikurse e theksuam më lart, pati fatin, meritën dhe nderin ta drejtonte e ta kryesonte Aqif Pasha. Idetë përparimtare, parimet demokratike dhe vizionet oksidentale të vendimeve të Kongresit të Lushnjës u çuan më tej nga Aqif Elbasani, sepse ai ishte i bindur se tashmë Shqipëria dhe populli shqiptar kërkonin ndryshime, transformime. Sikurse vinte në dukje një deputet i parlamentit të parë pluralist shqiptar: "Populli-theksonte deputeti i Dibrës Ramiz Daci, më 13 maj të vitit 1921 – kërkon ndryshimin e jetës së vet, një jetë e cila e ka lodhë, e ka shtypë prej shumë shekujvet. Shkurtazi , do të zotnojë e të mbretnojë vet. Sepse krijuesi nuk e ka krijuar njerëzinë për m'u ba rob. Një diktator, një feudal nuk ka ndonjë të drejtë, në të cilën të mbështetet e të zotnojë si i don zemra përmbi popull".[8] Kjo kërkesë e popullit shtronte para drejtuesve të jetës politike, dhe veçmas para liderëve të lëvizjes për transformim, pyetjen si duhej realizuar ky proces, në ç'formë, me ç'mjete, nëpërmjet cilës alternativë duhej ecur për t'i kënaqur e plotësuar interesat e kërkesat e popullit? Këtyre problemeve iu jepte zgjidhje Aqif Elbasani me Programin e Partisë Kombëtare. Për mendimin tonë programi përfaqëson një sintezë e platformë politike që përmbante rrugën e zgjidhjes oksidentale të problemeve, të zhvillimeve të shtetit shqiptar drejt krijimit të një shteti modern dhe shndërrimit të Shqipërisë në një vend të zhvilluar, të përparuar e të begatë.

Le të futemi në shqyrtimin e programit në fjalë. Që në fillim bie në sy emërtimi i Partisë që e themeloi Aqifi, Partia Kombëtare. A mos ishte emërtim pa domethënie politike? Kurrsesi. Asgjë nuk bënte dhe asgjë nuk lejonte Aqif Elbasani pa e kaluar në sitën e gjykimeve të interesave kombëtare. Ai e ndiente dhe e përjetonte gjithnjë me dhembje e me shqetësim të thellë shpirtëror copëtimin e trojeve etnike shqiptare më 1913. Jo vetëm që nuk u pajtua asnjëherë me atë padrejtësi historike, por punoi pandërprerë për korrigjimin e domosdoshëm të saj.

Vështruar në këtë sfond politik emërtimi Partia Kombëtare shprehte emërtim me synime dhe me domethënie. Ishte thirrje, ishte kujtesë dhe kërkesë për çdo shqiptar atdhetar. Ajo sillte në vizionin politik të çdo shqiptari idenë e detyrës e të detyrimit kombëtar të

[8] Gazeta "*Shkumini*", Elbasan, e premte 27 maji 1921.

papërmbushur, të parealizuar, për rrjedhojë edhe nevojën e angazhimit të vazhdueshëm për plotësimin e saj. Me këtë term Aqifi u drejtohej tërë shqiptarëve, bashkëkombësve kudo që ndodheshin, i drejtohej kujtesës historike dhe vetëdijes kombëtare të tyre. Ai besonte, dhe kishte të drejtë, në gjykimin e vet, se në atë mënyrë do të nxiste më shumë popullin dhe organet shtetërore shqiptare në lëvizjen për zgjidhjen e çështjes kombëtare.

Programit dhe rregullores së Partisë Kombëtare i paraprin një thirrje e Aqif Pashës, e cila nënshkruhet në fund prej tij. Thirrja u drejtohet gjithë shqiptarëve. Ajo në vetvete ishte një parashtresë, në të cilën shpjegohen shkaqet që diktuan krijimin e Partisë Kombëtare dhe hartimin e programit të saj politik. Aqifi shpjegon se këto nuk ishin shprehje të rastësishme, por rezultat i një përvoje të gjatë jete midis popullit. Duke iu drejtuar shqiptarëve, Aqifi theksonte: "Sot dhe unë plaku i vjetër po dalë përpara teje me programin tem. Ky program t'a dishë mirë se nuk është pema e një mendimi teorikë, por janë konviksionet (bindjet – H.K.) të një plakut i cili gjithë jetën e tij e ka kalumunë ndërmjet jush, si në ditë të mira ashtu dhe në të keqen, s'të ka lënë vetëm as në të qamen, as në të qeshmen, ti njef të mirat dhe të metat, ti çmon bukur vertutat dhe nevojat, shkurtazi janë frytat të një jetës politike të gjatë plot me msime dhe me prova".[9]

Ingranimi i pandërprerë në çdo rrjedhë politike e shoqërore shqiptare, u vlerësua nga populli, i cili e çmoi dhe e ngriti në nivelin e liderit të vet. Këtë e kuptonte mirë Aqifi, ndaj dhe nga këto pozita u drejtohej bashkëkombësve, sepse ishte i bindur se ata e dëgjonin, prisnin si gjithnjë prej tij.

Në thirrje ai shpalosi edhe ide e koncepte të rëndësishme për disa nga problemet më të mprehta të jetës politike të shtetit, të shoqërisë shqiptare dhe të mbarë kombit. Qysh në fillim mbron idenë e parlamentarizmit, të parlamentit, si institucion i demokracisë parlamentare, përbërja e të cilit të përcaktohej nga ekzistenca e partive politike me platforma të qarta, të plota dhe të përcaktuara. Përkrahte e kërkonte pluralizmin politik, pluralizëm ideshë dhe pluralizëm organizativ, konkurrimin e alternativave të ndryshme. "Parlamentarizma donë partia politike – theksonte në thirrje – partit politike mund të

[9] Programi dhe rregullorja e Partisë Kombëtaree (më tej PRPK) në: "*Studime Historike*", nr. 1-4/1995, faqe 143.

formohen vetëm me program,[10] parti pa program ashtë si një shtëpi pa plak, ku sicili flet po njeri s'dëgjonë". Pranonte dhe kërkonte alternimin e forcave politike në pushtet dhe diversitetin e konkurrimin e lirë të alternativave social-politike. Platformave politike të partive, sikurse shihet, u jepte rëndësi, sepse në to përcaktohej përmbajtja dhe publikoheshin gjithë objektivat e punës së tyre, shpreheshin interesa shtresash të caktuara të shoqërisë dhe gjykohej karakteri i veprimtarisë së tyre.

Ndryshe nga partitë e krijuara deri atëherë në Shqipëri, Partia Kombëtare kishte karakterin e një partie të vërtetë, me një platformë të plotë, të qartë e të gjithanëshme, që publikohej në opinionin e brendshëm e të jashtëm, si shprehësja dhe mbrojtësja e interesave kombëtare dhe shoqërore të popullit të vet. Aqif Pasha e kuptoi se pas Kongresit të Lushnjës, Shqipëria dhe populli shqiptar hyri në një etapë të re historike, përmbajtjen e së cilës e përcaktoi lufta për demokraci e përparim, përpjekja për oksidentalizimin e Shqipërisë, për ndërtimin e një shteti modern sipas shembullit dhe rrugës së zhvillimit të shteteve më të zhvilluara të Evropës Perëndimore. Ky proces i ri politiko-shoqëror, mbartës të të cilit ishin forcat politike intelektuale liberal-demokrate, të cilëve u përkiste edhe Aqif Elbasani, ndeshte në rezistencën e konservatorëve. Ndaj Aqifi parashikonte me të drejtë dhe kishte bindje të plotë për kontradiktat që ekzistonin midis këtyre dy forcave politike. Lufta politike ndërmjet tyre u shfaq qysh gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet e para parlamentare (shkurt-prill 1921) dhe u acarua më tej gjatë veprimtarisë së parlamentit (1921-1923). Kjo shkaktoi jo rrallë kriza politike, të cilat i sollën dëme zhvillimit të vendit.

Prandaj, me një notë kujdesi të theksuar, që ishte veçori e karakterit të tij, ia tërhiqte vëmendjen popullit shqiptar të kishte kujdes dhe të zgjedhte në parlament përfaqësues më të denjë, të cilët mbi gjithçka të vinin interesat e popullit, interesat kombëtare, ata që lufojnë "për të mirën tënde, që është pa dyshim e mira e Atdheut". Të zgjedhësh ata- i drejtohej ai – që të thonë "se ç'duan dhe ç'mundin[11] me ba" për vendin, për popullin dhe për kombin, për përparimin e tyre. Këtë e bëri ngaqë konstatoi dobësi në punën e parlamentit të parë pluralist, siç e vlerësonte veprimtarinë e tij. Sipas tij, parlamenti punoi "pa program, pa themel të shëndoshë, pa dritë dhe pa diell, të bazumun vetëm mbi personat, ambisionet dhe intrigat, kaq keq, kaq ligsht, punojë, sa mos e mçef, je

[10] PRPK, në '*Studime Historike*", nr. 1-4/1995, faqe 142.
[11] Po aty, faqe 142.

ftohë krejt prej saj dhe prej sistemit të parlamentarizmës".[12] Duke vënë në dukje këto, ai synonte të zgjonte te populli ndjenjën e përgjegjësisë për zgjedhjen e përfaqësuesve të vet. Ekzistencën e parlamentarizmës dhe të parlamentit, rolin vendimtar të tyre në jetën e një shteti, Aqifi i kuptonte si domosdoshmëri për zhvillimin e Shqipërisë. Prandaj, duke iu drejtuar nga larg bashkatdhetarëve të vet ai vinte në dukje se për gjendjen e rëndë që ekzistonte asokohe në Shqipëri "as parlamenti, as parlamentarizma janë fajtor, fajin e kanë ata njerëz, ata burra që luajtën me fatin e popullit e t' Atdheut pa mos ditë se ku po shkojnë dhe ku po të çojnë".[13] Aqifi nënvizonte edhe qëndrimin e vlerësimin e popullit ndaj deputetëve të parlamentit të parë pluralist. "Ti – i drejtohet ai popullit – me ftohtësinë që po kallzon, gjykimin tënd mbi atë e ke çfaqë mjaft bukur".[14] Megjithatë, ai nuk bëhet pesimist, sepse historia shqiptare e asaj kohe kishte përpara një shembull të vlefshëm, shembull që duhet ta merrnin e ta ndiqnin shqiptarët. Ishte federata "Vatra" e shqiptarëve t'Amerikës, "e cila, vinte në dukje ai – ka qenë dhe është gjithmonë prijësi i Atdhetarizmës, që ka çfaqë dhe proklamue programin politik të saj".[15]

Vepra, puna e saj i kishte sjellë shërbime të mëdha kombit tonë, prandaj duke e vlerësuar uronte: "Qoftë e lumtur dhe e bekueme ajo "Vatra" dhe kërkonte që shqiptarët të ndiqnin doemos shembullin e saj.

Me programin që publikonte dhe thirrjen që i paraprinte atij, Aqif Pasha prezentohet edhe njëherë tjetër si burrë shteti që i kuptonte qartë, drejt e plotësisht tendencat e prirjet politike të proceseve të zhvillimeve ekonomiko-shoqërore në Shqipëri dhe prioritetet e asaj etape të zhvillimit të shoqërisë shqiptare. Duke e ndierë përgjegjësinë historike për të marrë pjesë dhe për të kontribuar në atë proces historik "sot edhe unë plaku i vjetër – theksonte ai, duke iu drejtuar popullit – po dalë para teje me programin tem".[16] Për atë rruga e zhvillimit dhe e përparimit të vendit dhe mjetet e mënyra për ta garantuar ishte në dorën e shqiptarëve. Duke analizuar këtë ide, ai theksonte: "Bashkëatdhetar! Shumë miq, të jashtëm ose të mbrendshëm, nuk shkon ditë, që të mos më rekomandojnë bashkimin e shqyptarëvet... (nënvizimi im). Pra duke harrue të gjithë të kaluemet tue mbyllë ato faqe të zeza të historisë së re të Atdheut, po marr

[12] Po aty, faqe, 143.
[13] Po aty, faqe 143.
[14] Po aty, faqe 143
[15] Po aty, faqe 143.
[16] Po atu, faqe 143

inisiativën dhe po ju thërres me një za të naltë dhe me gjithë fuqi: Shqiptar! Bashkohuni rreth të programit të Partisë Kombëtare dhe shpëtimtare. Rreshtohuni me këtë program dor në dorë si vëllazën".[17]

Tani le të shohim, duke u përqendruar qoftë edhe fare shkurt, se cila ishte platforma politike e Partisë Kombëtare e shprehur nëpërmjet Programit.

Programi përmbante 28 nene.[18] Në to shqiptoheshin problemet më kardinale të jetës shqiptare, si problemi kombëtar, çështja e formës së regjimit politik të shtetit, aspekteve social-ekonomike, juridike, kulturore, çështje të ndërtimit e të funksionimit shtetëror, të administratës civile e ushtarake. Rëndësi u jepej shpalljes dhe garantimit të lirive politike e të drejtave demokratike, si liri fjale, liri shtypi, liri mbledhjeje, liri organizimi, liri besimi fetar etj. Vëmendje u kushtohej çështjeve të përmbajtjes së politikës së jashtme, orientimeve dhe drejtimeve themelore të saj. Mirëpo, synimi themelor, që përbënte edhe thelbin e Programit të Partisë Kombëtare, ishte dëshira për shndërrime të thella demokratike, politika e reformave liberal-demokrate për ta shndërruar shoqërinë shqiptare në shoqëri demokratike dhe shtetin shqiptar në shtet ligjor. Duhet theksuar se për të nuk kishte rëndësi vetëm thelbi e synimi i programit, por edhe metoda e realizimit të reformave që kërkonte të zbatoheshin në Shqipëri. Ai ishte vetëm për rrugën demokratike, paqësore të kryerjes së reformave, duke evituar krejtësisht dhunën dhe forma të tjera që sillnin tensione sociale.

Në nenin e parë të Programit shpallej çështja e regjimit, apo sistemit politik të shtetit shqiptar: "Mënyra e qeverimit të shtetit shqiptar – nënvizohej në program – ashtë Mbretnie Parlamentare (Monarchie Constitutionelle) (neni 1)",[19] pra monarki konstitucionale. Pranimi e shpallja e kësaj forme regjimi shtetëror duhet gjykuar në suazën e momentit historik, i cili gjithsesi e detyronte Aqifin ta pranonte i shtyrë nga motive dhe shkaqe të jashtme e të brendshme. Pranimi i monarkisë konstitucionale në vetvete përbënte një ripohim dhe rinjohje të vendimeve të Fuqive të Mëdha, me të cilat sikurse dihet u pajtua, për ato shkaqe që njihen, edhe Kongresi i Lushnjës. Prandaj Aqifi, të cilin lufta politike e detyroi të mërgonte, me këtë version shprehte pajtueshmërinë e plotë me vendimet e Kongresit të Lushnjës, të pranuara nga mbarë

[17] Po aty, faqe 143.
[18] Po aty, faqe 145
[19] Po aty, faqe 143.

populli dhe njëherazi konformizmin e tij edhe me përcaktimet e vendimet e Fuqive të Mëdha.

Struktura e piramidës shtetërore, që kërkonte Aqifi, frymëzohej nga idetë dhe ndërtimi i saj në botën oksidentale. "Fuqinat shtetnore – theksonte Programi i Partisë Kombëtare – ndahen në " Mbretin, Senatën, Parlamentin dhe Kabinet (neni 2).[20] Shihet qartë ideja e ndarjes së pushteteve. Veçse duhet dalluar një dukuri jo pa rëndësi. Ai kërkonte që Parlamentarizma në Shtetin Shqiptar të kishte dy dhoma (Senatin dhe Parlamentin) (neni 2). Një strukturë e tillë ekzistonte në shtetet me tradita parlamentare në Evropën Perëndimore. Kjo pikëpamje shprehte dëshirën e tij për ndërtimin e një shteti modern, sipas shembullit dhe strukturave të shteteve më të zhvilluara të Evropës Perëndimore.

Kërkesa dhe synimi i tij përputhej edhe me përpjekjet e intelektualëve liberal-demokratë që vepronin në Shqipëri, pjesa më e madhe e të cilëve ishte shkolluar në shkollat e vendeve të Evropës Perëndimore, dhe kërkonin, madje u bënë nxitës të idesë së oksidentalizimit të Shqipërisë, si kusht vendimtar për zhvillimin e saj. "Orientimi nga Perëndimi shpëtimi jonë i vetmi"[21] ishte titulli i kryeartikullit të revistës "Djalëria" (janar 1922), që e nxirrte shoqëria e studentëve shqiptarë në Austri. Shumica e intelektualëve që vepronin asokohe në Shqipëri ishin shkolluar në vendet e Evropës Perëndimore. Mjafton të themi se në vitin 1924 jashtë shtetit studionin 131 studentë e nxënës nga të cilët 69 në Austri, 49 në Itali, 7 në Francë, 2 Jugosllavi, 2 në Gjermani, dhe 2 në Turqi.[22] Ideja e oksidentalizimit të Shqipërisë, si alternativë që siguronte dhe garantonte suksesin e zhvillimit e të përparimit të vendit ishte përhapur dhe po fitonte terren. "*Ne pasuesit e kulturës perëndimore* – vihej në dukje në një thirrje të publikuar në shtypin e kohës – *kërkojmë që patriotizmi dhe oksidentalizmi, që janë dy pikat kryesore të ekzistencës sonë politike të jenë të konfirmuara sheshazit, jo me fjalë e me prralla, por me vepra të gjalla, të qarta e të padyshueshme*"[23]. (nënvizimi im). Kjo kërkesë e intelektualëve shqiptarë u mishërua në Programin e Partisë Kombëtare. Jetës politike shqiptare brenda vendit i vinte nga larg edhe një alternativë e re e parashtruar nga një opozitar jashtë vendit në emigracion, vija dhe qëndrimet politike të të

[20] Po aty, faqe 143.
[21] Revista "*Dialëria*," Vjenë 1922, nr. 15-16, faqe 1-3
[22] Bisedimet e Kuvendit Kushtetues 1924, faqe 272.
[23] Gazeta "*Ora e Maleve*", Shkodër 20.09.1924.

cilit përputheshin plotësisht me vijën dhe qëndrimet politike të opozitës demokratike që vepronte asokohe brenda në Shqipëri.

Pasi shtjellon çështjen e strukturës së piramidës shtetërore, programi jep vlerësimin për domosdoshmërinë e sigurimit të sovranitetit dhe pavarësisë së shtetit shqiptar. "Indipendenca e plot e shtetit është një bazë e shënjtë" (neni 3),[24] thekson programi. Kjo pikëpamje është vazhdim i mëtejshëm i konceptit të palëkundur të Aqifit mbi nevojën dhe domosdoshmërinë e krijimit të shtetit të pavarur e sovran shqiptar dhe shprehje e papajtueshmërisë së tij me pikëpamjet që qarkullonin jo rrallëherë asokohe në tavolinat e diplomacisë apo konferencat ndërkombëtare, mbi gjoja paaftësitë shtetformuese të shqiptarëve. Idetë e koncepti i tij mbi shtetin shqiptar nënkuptonin dhe përfshinin shtrirjen e shtetit në gjithë hapësirën etnike shqiptare. "Kufijtë e Shqipërisë i ka caktuar Perëndia – theksohej në nenin e 4 të programit – s'mund të ndryshohen në favor të kurkujt" (neni 4)[25]. Aluzioni ishte i qartë. S'kishte të drejtë askusht t'i ndryshonte ata kufij që kishte përcaktuar Zoti. Pra, thuhej hapur se ata që kishin ndryshuar kufijtë, që kishin ndarë etninë shqiptare në dy pjesë, ishin përgjegjës edhe para Perëndisë, ishin mëkatarë dhe për këtë duhet t'i vriste ndërgjegjja për padrejtësinë, që i kishin bërë një populli, një vendi dhe një etnie.

Koncepti i unitetit territorial të etnisë shqiptare për Aqif Pashën ishte i pandarë nga uniteti, konstitucioni shpirtëror kombëtar shqiptar. "Shqipëria është për gjithë Shqiptarët-theksonte programi – dhe gjithë shqiptarët janë vllazën" (neni 6).[26] Thirrje për bashkim kundër përçarjes për unitet e bashkësi interesash politike e territoriale për kombin e tyre. Parimet bazë të politikës së jashtme do të ishin: largim prej çdo aventure, miqësi me të gjithë fqinjët, afrim me shtetet e pa interesueshme politikisht në Shqipëri (neni 13).[27] Për të konceptet e politikës së jashtme përcaktoheshin nga vlera dhe roli i tyre në shërbim të realizimit të interesave të popullit e të kombit, prioritete që mbronin pavarësinë, tërësinë territoriale të shtetit shqiptar dhe synonin bashkimin e trojeve etnike shqiptare. Në këtë kuadër ai vlerësonte shumë dhe më të drejtë, rolin e Lidhjes së Kombeve. "Hija e Lidhjes së Kombeve – theksonte programi – është shumë e vlefshme për Shqypënien"[28]. Te komuniteti

[24] PRPK në "*Studime Historike*", nr. 1-4/1995, fq.143.
[25] Po aty, faqja 143.
[26] Po aty, faqe 143.
[27] Po aty, faqe 144.
[28] Po aty, faqe 144.

dhe organizmat ndërkombëtarë, sikurse ishte Lidhja e Kombeve, Aqifi besonte se shqiptarët mund të gjenin mbështetje për realizimin e aspiratës kombëtare.

Partia Kombëtare përkrahte oksidentalizimin e Shqipërisë, sepse sikurse theksohej në nenin 10 të programit, "qytetënimi oksidental mund të përmirësojë dijenin, moralin, shëndetësinë dhe ekonominë e kombit tonë".[29] Me të drejtë ai e vlerësonte shumë rolin dhe kontributin e madh që do të kishte për zhvillimin e kombit shqiptar orientimi nga Perëndimi dhe largimin nga orientimi lindor, nga praktikat, legjislacioni, mentalitetet e konceptet orientale. Në këtë nen studiuesi i vëmendshëm vë re edhe njëherë tjetër se Aqifi çështjet e shtruara në Programin e Partisë i shikon në rrafshe kombëtare.

Në fushën ekonomike Partia Kombëtare dhe themeluesi i saj kishin "bindjen se Shqipëria mund të bëhej vetëm një shtet i bujqësisë" (neni 9)[30] Siç shihet koncepti i tyre ishte i ngushtë. Të ardhmen e zhvillimit ekonomik e shikonim vetëm si vend bujqësor. Kjo bindje i shtynte të besonin se ngritja e pasurisë kombëtare do të varej nga zhvillimi i bujqësisë. Për realizimin e këtij qëllimi kërkonte zbatimin e një sërë reformash, apo siç shprehej programi – "tue pranue reformat më të gjëra të bujqësisë"[31], por, ndonëse pranohej nevoja dhe domosdoshmëria e reformave, nuk shprehej se për çfarë reformash ishte fjala, ç'natyrë, ç'përmbajtje, ç'drejtim do të kishin ato. "Çdo bulk do të kishte tokën e vet. Shteti do t'u shpërndante edhe atyre që nuk kishin tokë[32], pohohej në program. Shpërndarja do të merrte parasysh një sërë kushtesh "nevojën e vendit dhe kohën".[33] Gjithsesi, nga sa shihet është fjala për reformë agrare, por nuk thuhet si do kryhej, në çfarë drejtimesh dhe cilat prona do të prekte? Nuk bëhet fjalë se sa hektarë tokë duhej t'u jepeshin fshatarëve pa tokë, bujqve, apo fshatarëve me pak tokë. Toka do t'u jepej me shpërblim apo pa shpërblim? Do prekeshin pronat e çifligarëve të mëdhenj apo jo? Pavarësisht nga këto paqartësi, shtruarja e problemit kishte rëndësi të madhe dhe dëshmonte se Aqifi ishte ndër të paktët personalitete politike, që e kuptuan se në Shqipërinë e viteve 20, sikurse vinte në dukje asokohe edhe Faik Konica[34] problemi agrar dhe

[29] Po aty, faqe 144.
[30] Po aty, faqe 144.
[31] Po aty, faqe 144.
[32] Po aty, faqe 144.
[33] Po aty, faqe 144
[34] Gazeta "*Shqiptare i Amerikës*", Korçë, 13.01.1923.

domosdoshmëria e zgjidhjes së tij ishte kërkesë dite dhe çështja themelore e jetës ekonomiko-politike të vendit. Nga mënyra, shkalla dhe thellësia e zgjidhjes së çështjes agrare, varej ecuria e ritmeve të zhvillimit ekonomiko-social të vendit. Për këtë arsye dhe nisur nga këto pozita Programi theksonte me të drejtë se zhvillimi i vendit dhe ngritja e "pasurisë kombëtare"[35] do të arriheshin vetëm "tue pranue reformat më të gjëra të bujqësisë"[36]

Partia njihte paprekshmërinë e pronës private dhe shpallte shenjtërinë e saj. "Në të drejtat pronësie dhe tokësore s'mund të përzihet një tjetër pa ndonjë kompetencë ligjore"[37] (neni 21), nënvizonte Programi.

Vizioni politik i Aqifit për problemet ekonomike, i shprehur në Programin e Partisë, ishte i gjerë dhe në themelin e vet kishte idenë e tërheqjes së kapitalit të huaj për investime në Shqipëri dhe të dhënies së koncesioneve. Por për këto probleme ai tërhiqte vëmendje, duke theksuar domosdoshmërinë e ruajtjes dhe të forcimit të pavarësisë së vendit "Ekonomia e vendit tonë – shprehej programi – s'mund të ngrihet pa ndihmat e kapitalit të huaj"[38] (neni 11), por vihej në dukje më poshtë – "Partia është armik i atij kapitali që sjell intriga politike në Shqipëri" (neni 11). Gjithashtu ajo kishte parasysh edhe ruajtjen e mbrojtjen e interesave ekonomike të shqiptarëve e të kapitalit të tyre, gjë që e shprehte edhe njëherë haptas kur theksonte se "gjithë konçesionet do të jepen me një konkurencë. Kapitali i brendshëm do të përkrahet më fort"[39] (neni 12. Parimi bazë i programit financiar të partisë përmblidhej në devizën : "*shumë punë, pak taksa, shpenzime me nevojë*"[40] (neni 19) (nënvizimi im H.K.). Përmirësimin dhe shëndoshjen e gjendjes financiare të shtetit ai e shihte në zbatimin e një plani të gjerë "punësh botore", të cilat do të "shtonin të ardhurat e shtetit", madje, sipas saj, shteti shqiptar gjithë fuqinë e vet duhet t'ia kushtonte punëve botore, mbasandaj arsimit"[41] (neni 15), "Mësimin fillor e konsideronte të domosdoshëm". Pastaj kërkonte vazhdimin e shkollës në nivele më të larta. Thelbi i mësimeve në çdo shkallë ishte që t'i "jepej brezit të ri një edukatë plot

[35] PRPK në "*Studime Historike*", nr. 1-4/1995 faqe 144.
[36] Po aty,
[37] Po aty
[38] Po aty.
[39] Po aty.
[40] Po aty.
[41] Po aty, faqe 144

me shpirtin nisiativ, duke ruajtur ndjenjat fetare të tij"[42] (neni 7). Çështja e arsimimit vlerësohej në kuadrin e rolit të madh të dijeve e të kulturës për zhvillimin e vendit dhe emancipimin e shoqërisë shqiptare. Fryma iluministe dhe iluminizmi si ide me natyrë dhe tipare demokratike i shërbente lëvizjes demokratike shqiptare. Kjo ishte arsyeja kryesore që shpjegon pse në programin dhe në strategjinë e liberal-demokratëve dhe të inteligjencies përparimtare të viteve 1920-1924 iu dha rëndësi e madhe përhapjes së arsimit, kombëtarizmit dhe demokratizimit të shkollës shqiptare.

Ndër problemet që tërheq vëmendjen në Programin e Partisë ishte kuptimi i drejtë dhe vlerësimi i lartë i rolit të pushtetit juridik në sistemin e organeve shtetërore dhe për gjithë vendin e shtetin. "Drejtësia – thuhej në Program – është rrënja e shtetit"[43](neni 20). Por për të ishte e nevojshme që në Shqipëri të krijohej "një sistem drejtësie sipas zakoneve të vendit dhe sipas karakterit të popullit"[44] (neni 20), gjë që nënkuptonte mënjanimin e normave, koncepteve dhe praktikave juridike që ekzistonin asokohe në vendin tonë. Ishte fjala për legjislacionin otoman që ende vepronte në Shqipëri. Për realizimin e kësaj kërkese ishte e domosdoshme "riformimi i drejtësisë"[45], që parashikohej të plotësohej nëpërmjet reformave që do të kryheshin me sistem. Në atë rrugë parashikohej të hartohej legjislacioni shqiptar, si domosdoshmëri, për t'iu përgjigjur kërkesave të reja të etapës historike në të cilën kishte hyrë shoqëria shqiptare.

Partia zotohej t'i garantonte popullit liritë politike dhe të drejtat demokratike "liri fjale, liri shtypi dhe liri mbledhjeje "[46] (neni 9). Madje shpallej se ato konsideroheshin "të drejtat më të shënjta të kombit, që s'mund të ndaloheshin ose të kufizoheshin me asnjë mënyrë"[47] (neni 9). Në këtë kuadër shpallej liria e besimeve fetare. "Në Shqipëri gjithë fetë janë të lira dhe të ndershme" (neni 5).

Angazhimi për garantimin e lirive dhe të drejtave politike e demokratike përbënte një tjetër dëshmi të përpjekjeve të Partisë dhe të themeluesit të saj për demokratizimin e jetës politike e shoqërore, për krijimin e shoqërisë civile dhe për ngritjen e nivelit të qytetërimit në

[42] Po aty.
[43] Po aty.
[44] Po aty.
[45] Po aty.
[46] Po aty.
[47] Po aty, faqe 143.

nivele evropiane. Madje, sikurse e theksova më lart, ato vlerësoheshin si "*të drejta më të shënjta të kombit*" (nënvizimi H.K.).

Sa i përket administratës shtetërore programi theksonte: "Administrata e bendshme do të rregullohej sipas formulës: "Qeveria dhe qeveritarët janë shërbëtorë të popullit, jo zotërinjtë e tij"[48] (neni 23) (nënvizimi im H.K). Për organizimin dhe strukturimin e çdo "dege të administratës shtetërore do të thirreshin organizatorë të huaj me fuqi të plotë"[49](neni 14).

Në Program publikohej pikëpamja e Partisë për organizimin e forcave të armatosura, të cilat, në etapën fillestare, sipas saj, duhet të përbëheshin nga "një xhandarmëri e fortë, e disiplinuar dhe sipas nevojave praktike të vendit për të ruajtur kufijtë dhe qetësinë".[50] Kjo pranohej dhe shpallej si zgjidhje e përkohshme (sot për sot, vinte në dukje programi), sepse me shtimin e të ardhurave, me fuqizimin ekonomik parashikohej të organizoheshin "forcat ushtarake brenda një numri të caktuar"[51] në përputhje me mundësitë financiare dhe nevojat e shtetit.

Së fundi programi shpallte edhe të drejtën për zgjedhje e për t'u zgjedhur. "Çdo shqiptar burrë 20 vjeç ka të drejtë me zgjedhë, ata 30 vjeç me u zgjedhë. Vetëm ata shqiptar që kanë mbaruar pak së paku Gjimnazin "Idadien" ose që kanë në vend të tyre një rëndësi sociale të posaçme mund të zgjidhen për deputetë ose senatorë"[52] (neni 25), theksonte programi. Duke vazhduar nënvizonte: "Çdo shqiptar mund të zgjidhej si deputet ose senator vetëm prej atij qarku, ku të ketë lindur ose ndejtë ma të paktë 5 vjet dhe të jetë pronar. Për çdo 15000 frymë zgjidhej një deputet e për çdo 30000 një senator (neni 27). Zgjedhjet bëhen sipas sistemit proporcional[53] (neni 28). Censi i arsimit dhe i pronës, mbase janë parashikuar si faktor që do të ndikonin në futjen e intelektualëve në organin përfaqësues, ndërsa për personat që kishin pronë nga që nuk ndjenin nevojën për të ardhura të tjera, sepse shteti për shkak të vështirësive financiare, nuk kish mundësi t'u përgjigjej me pagë deputetëve. Por, siç shihet, prioritet i jepej arsimit, kur pohohej: "Vetëm ata shqiptar që kanë mbaruar pak së paku gjimnazin "Ida-dien" mund të

[48] Po aty, faqe 144.
[49] Po aty, faqe 144.
[50] Po aty, faqe 144.
[51] Po aty, faqe 144.
[52] Po aty, faqe 145.
[53] Po aty, faqe 145.

zgjidheshin deputet apo senatorë". Kjo lidhej me vlerësimin e rolit të intelektualëve në jetën politike e shoqërore të vendit dhe afrimin e angazhimin e tyre në jetën politike, pikëpamjet e të cilëve i paraprinin mendimit politiko-shoqëror të kohës, dhe kjo shtresë njihej për pikëpamjet e saj përparimtare liberale-demokratike. Nga sa theksuam më sipër mund të konkludojmë se, vështruar në raport me kërkesat e kohës, Programi i Partisë Kombëtare përbënte një përgjigje për zgjidhjen e detyrave historike të momentit dhe i shërbente luftës për demokraci, për ndërtimin e shtetit modern shqiptar, sipas shembullit dhe strukturave të shteteve më të zhvilluara të Evropës Perëndimore.

Programi dhe Rregullorja e Partisë Kombëtare, qe Aqif Pashe Elbasani krijoi e drejtoi me 1923, gjatë kohës së mërgimit në Austri

Prill 1923

Bashkeqytetar:

Parlamentarizma done parti politike, partitë politike mund të formohen vetem me program. Parti pa program asht si nje shtepi pa plak, ku secili flet po njeri s'degjone. Zgjedhjet per parlamentin e pare te Shqipnise nuk do ti kesh harruar, atehere shume njerez te kerkojshin voten, pa mujt me te thene se per ty, per te miren tende, qe eshte pa dyshim e mira e Atdheut, se c'duan dhe c'mundin me ba. Kur ke dhene voten per ato zgjedhje, e di fort mire, se ke ba po si ai qe shtjen nje pushke ne t'erret pa pa gja. Por, bashkatdhetar, a e dine se me ket pushke ke qene tue vra veten dhe, per pak, Atdheun te dashur. Pse parlamenti i pare qe leu prej votes tende dhe te shokeve tuaj, pa program, pa themel te shendoshe, pa drite dhe pa diell, te bazuar vetem mbi personat, ambisionet dhe intrigat kaq keq, kaq ligesht punoje, sa mos e mcef, je ftofe krejt prej saj dhe prej sistemit te parlamentarizmes.

Nuk dua me ti permend gjithe trazimet dhe ngaterrimet qe ti ka sjelle ai, nuk dua me ti permend gjaket qe jane derdhe, vellavrasjet qe jane ba, katundet qe jane djeg, shtepiat qe jane fik vetem, po vetem me sjelljet te keqia dhe fantastike te kesaj, bije fjala parlamentit. Ti me ftohtesin qe po kallezon, gjykimin tend mbi ate e ke cfaqe mjaft bukur.

Por bashkatdhetar i dashur, as parlamenti, as parlamentarizma jan fajtor, fajin e kane ato njerez, ato burra qe lujten me fatin tand e t'Atdheut pa mos dite se ku po shkojne dhe ku po te cojne.

Qofte e lumtur dhe e bekueme ajo "Vatra", e cila ka qene dhe eshte gjithmone prijesi i Atdhetarizmes, qe ka cfaqe dhe proklamue programi politik te saje.

Sot dhe une, plaku i vjeter, po dale perpara teje me programin t'em. Ky program, ta dishe mir se nuk eshte pema e nje mendimi teorik, por jane konviksionet (bindjet-H.K.) te nje plakut i cili gjithe jeten e tij e ka kalumun ndermjet jush, si ne dit te mir ashtu dhe ne te keqe, s'te ka lene vetem as ne te qamen as ne te qeshmen,ti njef te mirat dhe te metat, ti cmon bukur virtutat dhe nevojat, shkurtazi jane frytat te nje jete politike te gjate plot me mbetje dhe me prova.

Bashkatdhetar! Shume miq te jashtem ose te mbrendshem, nuk shkon dite, qe te mos me rekomandojne bashkimin te Shqyptarevet; si baze per kete bashkim e nuk mjaftone ky program? Pra duke harrue te gjithe te kalumet, tue mbylle ato faqe te zeza te historise se re te Atdheut, po marr inisiativen dhe po ju therres me nje za te nalte dhe me gjithe fuqi: Shqiptar! Bashkohuni ne rreth te programit te Partise Kombëtare dhe shpetimtare. Rreshtohuni me ket proram dore ne dore si vellazen.

Aqif Pashe Elbasani

Program[54]*, i Partise Kombëtare*

1-Menyra e qeverimit te Shtetit Shqiptar asht: Mbretenie parlamentare (Monarchie constitutionelle)

2-Fuqinat shtetnore ndahen nen: Mbretin , Senaten, Parlamentin dhe Kabinetin.

3-Indipendenca e plot e shtetit ashte nje baze e shenjte.

4-Kufijte e Shqipnise i ka caktuar Perendia,s'mund te ndryshon ne favor te kurkujt.

5-Ne Shqipni gjith fete jane te lira dhe te ndershme. Partia lifton rreptesisht kundra te pafeve

6-Shqipnia eshte per gjithe shqiptaret dhe gjithe shqiptaret jane vellazen.

54 Programi dhe Rregullorja e Partise Kombetare eshte kopjuar nga origjinali qe ndodhet në Biblioteken Kombetare, me kete indikacion S 11 G 150. Origjinali eshte nje broshure e vogel me balline te kuqe me shirita te zinj. Broshura ka 12 faqe, nga te cilat 2 faqe janë thirrje te Aqif Pashes 4 faqe kanë Programin dhe 6 faqe Rregulloren e Partise Kombëtare.

7-Mesimi fillor eshte i domosdoshem. Ne çdo shkalle te mesimit do ti nepet gjeneracionit te ri nje edukate plot me shpirtin inisiativ, megjithkete do te ruhen ndjenjat fetare të tij.

8-Partia Kombtare eshte e bindur se Shqiperia mund te behet vetem nje shtet i bujqesise, pra shikon me ngrijt pasunien Kombetare tue pranue reformat me te gjera te bujqesise.

9-Liri fjale, liri shtypi, dhe liri mbledhjeje jane te drejtat me te shenjta te Kombit, s'mund të ndalohen ose te kufizohen me as ndonje menyre.

10-Partia Kombetare nuk ashte anmik i qytetenimit Oksidental, i cili mund te permiresoje dijenin, moralin,shendetsien dhe ekonomien e kombit tone,refyzon çdo allafrengllek qe e shtyn popullin ne mjerie, vorfnie, ose mizerje.

11-Ekonomia e vendit tone s'mund te ngrehet pa ndihmat e kapitalit te huaj. Partia eshte armik i atij kapitali qe sjell intriga politike me vete ne Shqiperi.

12-Gjithe koncensionet do te jepen me nje konkurence, kapitali i brendshem do te perkrahet sa me fort.

13-Largim prej çdo aventure, miqesi me te gjithe fqinjet, afrim me shtetet e pa interesushme politikisht ne Shqipni jane bazat e politikes se jashtme. Hija e Lidhjes se Kombeve eshte shume e vlefshme per Shqypnien.

14-Per çdo dege te administrates do te thirren organizatore të huaj me fuqi te plote.

15-Shteti Shqiptar gjithe fuqine dhe energjine qe ka do t'ia japi puneve botore, masandaj arsimit.

16-Deri sa te mbarohet programi i puneve botore dhe te shtohen te ardhurat e shtetit, Shqipnia s'mund te mbaje nje ushtri te madhe.

17-Pra, Partia Kombetare pranon si fuqi vepruese sot per sot nje gjindarmeri te fort te disiplinueshme, dhe t'organizueme, sipas nevojave praktike te vendit, e cila do te ruaj qetesine dhe kufijt.

18-Huat per buxhetin ordinare shembin themelin e shtetit, prandaj nuk do te behen pervec puneve botore ose arsimore.

19-Programi financiar i Partise Kombetare permblidhet me keto fjale: shume pune, pak taksa, shpenzime me nevoje.

20- Drejtesia eshte rrenja e shtetit, nje sistem drejtesie sipas zakoneve te vendit dhe mbas karakterit te popullit mund t'a shendoshi kete rrenje. Me riformimin e drejtesise lehtesina te medhaja duhen sigurumun popullit e sidomos katundarit tue organizue gjyqtar-shetites.

21-Ne te drejtat pronesije dhe tokesore s'mund te perzihet nji tjeter pa ndonji kompetence ligjore:
22-Çdo bujk do te kete token e vet. Shteti do t'ju perndanje (shperndaje-autoret) dhe atyre qe nuk kane, mbas nevojes te vendit dhe te kohes.
23-Administrata e mbrendshme do te rregullohet mbas ketij formulit (Qeveria si qeveritaret jane sherbetoret e popullit, jo zotnijt e tij).
24-Çdo Shqyptar burre 20 vjec ka te drejte me zgjedhe, ato 30 vjec me u zgjedhe.
25-Vetem ato shqiptar qe kane mbaruar pak se paku Gjimnazin "ida-dien" ose qe kane ne vend te tyre nje randesi sociale te posacme mund te zgjidhen per deputete ose Senatore.
26-Çdo Shqyptar mund te zgjidhet si deputet ose Senator vetem prej atij qarkut, ku te kete lindur ose te kete ndejte ma te pakte 5 vjet dhe te jete pronar.
27-Per cdo 15 000 fryme zgjidhet nje deputet, e per çdo 30 000 nje Senator.
28-Zgjedhjet behen mbas sistemit proporcional".

Rregullorja e Partisë Kombetare

Neni 1. Organizimet e Partise Kombetare jane:

a) Nje keshille Politike (K.P.)
b) Nje keshille Qendrore (K.Q)
c) Deget (D)

Neni 2. Keshilla Politike

Perbehet prej tre vetesh dhe rregullon pergjithesisht politiken e brendshme dhe te jashtme.

K.P.zgjidhet prej Kongresie te Pergjithshem te Partise per tre vjet dhe kane te drejte te rizgjidhen. K.P. zgjedh kryetarin e saj vete, i cili eshtë Kryetar i Pergjithshem, d.m.th. plaku i Partise. C'do anetar i Partise, qe ka nje rendesi politike dhe i ka sherbyer Atdheut mund te zgjidhet per K.P.

Neni 3. Keshilla Qendrore

Perbehet prej 6 vetesh, rregullon punet e brendshme te Partise, inspekton deget, zbaton urdhrat e K.P. mbaron (harton H.K.) listen e kandidateve per Parlament ose Senat, drejton shtypin dhe propoganden e Partise.

K.Q.zgjidhet prej Kongresit Pergjithshem te Partisë per 1 vit dhe kane te drejte te rizgjidhen. Zgjedhin kryetarin e tyre, i cili quhet (Sekretar i Pergjithshem i Partisë). C'do anetar i Partise mund te zgjidhet per K.Q.

Neni 4. Organizimi i Keshilles Qendrore

a)Seksioni i administrates
b(Seksion i finances
c)Seksioni i disiplines

Seksion a) merret me administraten, inspektimin dhe zgjerimin e Partise, drejton shtypin e propaganden e saj.

Seksioni b) rregullon financen dhe mban buxhetin e Partise.

Seksioni c(merret me ceshtje disiplinore dhe ze vendin e nje Keshilli te Nderit.

Neni 5. Deget

Keshilli administratvi i degeve perbehet prej 4 vetesh dhe zgjidhen prej Kongresit te pervitshem te deges.

K.A. zgjedh Kryetarin e saj dhe kane te drejte te rizgjidhen.

Detyrat e degeve

Te zgjerojne organizimin per te fituar anetare te rinj, te bejne propagande duke spjeguar qellimin e programin e Partise, te perpiqen me c'do menyre legale per te fituar ne zgjedhjet. Deget per zgjedhjet e Bashkise ose Keshillit Administrativ te vendit bejne listen e kandidateve vete. Sa i perket zgjedhjeve parlamentare dhe Senatore i propozojne K.Q. dy kandidat per c/do deputet ose Senatore te atij qarku. Lista qe te vije prej K.Q. eshte perfundimtare dhe dega eshte e detyruar te perpiqet me gjithe fuqine per realizimin e saj.

Neni 6. Pranimi i anetarevet.

C'do shqiptar qe ka te drejte te zgjedhe dhe ka pranuar Programin e Partise me nje shkrese sipas modelit Nr. 1 pranohet ne Parti.

Neni 7. Hapja e degevet

4(kater) vete qe pranojne programin e Partise i bejne K.Q. një deklarate sipas modelit Nr.2 edhe kerkojne leje per hapjen e nje dege. Mbasi te marrin lejen e hapin degen dhe e shpallin me ndermjetsi te shtypit ose me mjete te tjera lokale dhe keshtu fillojne te pranojne antar.

Neni 8. Te ardhurat e Partise

C'do antar i paguan arkes se deges nje pagese te permuajshme. Keto pagesa si ndihmat e vecanta te antarve formojne te ardhurat e Partise. Sherbimet e degeve jane pa pagese. C'do dege ne fund te muajit mbetjet ia dergon K.Q.

Neni 9. Kongreset (Mbledhjet vjetore te degeve- H.K.)

Çdo vit me 1 prill mblidhet Kongresi i pervitshem i deges, degjon e shqyrton raportin dhe balancen e K.A. Mbasi te lirohet K.A. nga gjegjesia (pergjegjesia), plaku i Kongresit ze vendin e Kryetarit dhe zgjedh tre vete dhe me keta formone Byrone e zgjedhjeve. Byroja harton listen e kandidateve per K.A. te ri prej (8) vetesh dhe ia shperndane kongresisteve. C'do kongresist seleksionon listen duke lene vetem 4 emra te pelqyer prej tij dhe e hedh ne arken e zgjedhjeve. Mbasi hidhen gjithe listat, arka hapet ne mbledhje e siper dhe cdo liste lexohet me ze te larte. Ata 4 kandiate qe te ken fitur me shume vota perbejne K.A. e re dhe me vota te fshehta dhe nen kryesine e plakut zgjedhin kryetarin e tyre Plaku me ze te larte shpall emrat e K.A.

Byroja e zgjedhjeve eshte e detyruar te mbaje nje protokoll dhe me nenshkrimin e kryetarit ja con K.Q. duke i bashkengjitur cdo ankim ose proteste te nje shumices se ¼ te kongresisteve. Nen kryesin e kryetarit te ri kongresi zgjedh 2 delegate per kongresin e pergjithshem te Partise. Me

ne fund kendohet marshi Kombëtar (Hymni Kombetar – H.K.) dhe kongresi mbyllet.

Kongresi i deges s'mund te hapet pa u prezentuar 2/3 e antareve te degeve. Perkundrazi mbledhja lihet per nje dite tjeter, ku s'kerkohet me shumice por hapet me ata qe te jene prezentuar.

Neni 10. Kongresi i Pergjithshem i Partise

Per vit me 1 maj mblidhet Kongresi i Pergjithshem i Partise, ne te cilin marrin pjese nga dy delegate per cdo dege, anetaret e K.P. dhe Q., deputetet e senatoret e Partise. Kendohen (lexohen-H.K.) raportet e veprimeve permbi administraten, financen, disiplinen, propaganden dhe zgjedhjet e degeve. Per shqyrtimin e cdo raporti emerohet me vota te fshehta nga nje komision prej tre vetesh, ne te cilin K.P. dhe K.Q.s'mund te marrin pjese.

Cdo komision i paraqet Kongresit nje procesverbal mbi raportin qe ka studiuar.

Mbasi te lirohet K.Q. nga pergjegjesia, nen kryesin e Plakut te Partise me dy (2) antaret e K.P. dhe me tre (3) kongresist te zgjedhur prej Plakut vete formohet byroja e zgjedhjeve. Zgjedhjet zhvillohen sipas nenit 9.

Perfundimin e zgjedhjeve e shpall Plaku i Partise me ze te larte dhe mbyllet Kongresi me Hymnin Kombetar. Kongresi merr fund me nje gosti te festueshme.

Neni 11

Keshilli Politik zgjidhet sipas neneve 9 e 10 me kete ndryshim qe byroja e zgjedhjeve formohet prej Plakut te Kongresit edhe prej 5 vetesh te zgjedhur prej tij.

Neni 12

Kongresi i Pergjithshem ka te drejt te ndryshoje dhe te zgjeroi programin ose rregulloren e Partise me 2/3 e votave.

Model 1

Kopia e deklarates per hapjen e degeve

Ne te nenshkrurit----------duke pranur plotesisht programin e Partise Kombetare duam te hapim nje dege te kesaj Partije. Pra i lutemi K.Q. te na japi leje dhe te na dergoi dokumentet e nevojshme.

Kater (4) nenshkrime

Model 2

Kopia e deklarates per antare

Une i nenshkruri deklaroje se pranoje programin dhe rregulloren e Partise Kombetare dhe detyrohem t'i paguaj arkes se Partise ..... mujore.

Nenshkrimi